

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE NËNTOR 2025						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesë	Tarifa
42	30.10.2025	Pershendetje, Jam i interesuar per kredine studentore dhe ju shkruaj per te marre nje informacion me te detajuar se ai i prezantuar ne vendimin Nr.440, datë 19.7.2023. Do doja te dija nese perlogaritja e kosos se jeteses, aktualisht deri ne masen 40.000ALL, konsiderohet si shuma totale per te gjithë vitet e studimit apo si nje shume vjetore ose mujore. Ne rastin konkret, universiteti dhe dega e zgjedhur nuk jane nder ata me prioritet dhe tarifa totale e studimit per 3 vite do te ishte 90.000ALL. Mund te me thoni ju lutem se cila shume mund ti shtohet asaj kostoje e te konsiderohet si e arsyeshme per te mbuluar jetesen pergjate 3 viteve te studimit? Ju falenderoj per disponueshmerine. Ju uroj nje dite te mbare dhe qendroj ne pritje te përgjigjes suaj. Me respekt,	30.10.2025	Përsëndetje, Në vijim të emailit të mëposhtëm ju informojmë se vlera e kredië studentore përlogaritet duke përfshirë: Tarifën e studimit, që përfshin pagesën për tre vitet akademike; Kostot e jetesës të cilët përlogariten deri në kufirin e pagës minimale (Psh: 9 muaj × 40,000 lekë = 360,000 lekë, që përbën totalin e kostove të jetesës për një vit). Ju do ta përlogaritni koston e jetesës për tre vite nëse jeni student i vitit të parë në ciklin Bachelor. Për tre vite 360,000 X 3 = 1,080,000). Ju mund të aplikoni në këtë link: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=16066. Për çdo paqartësi mund të na shkruani, Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
43	03.11.2025	Përsëndetje, Po ju shkruaj për të marrë informacion të mëtejshëm mbi vazhdimin e këtij rasti: Kam përfunduar më Korrik të 2025-ës, studimet Bachelor në Universitetin e Vlorës për një program prioritar (Gjuhë-Letërsi). Përgjatë tri viteve kam përfunduar bursën për programet prioritare, sipas marrëveshjes së nënshkruar me Universitetin e Vlorës. Po vazhdoj studimet Master në Universitetin e Tiranës në programin "Mësuesi në Gjuhë-Letërsi". Për të vazhduar me përfitimin e bursës, kam dorëzuar pranë "AKFAL" dokumentacionin me listën e notave për tri vitet dhe të shlyerjes së detyrimeve akademike. C'duhet të bëj më tej për të përmbyshur dokumentat që kërkojnë për përfitimin e bursës së programeve prioritare në Master, meqenëse kam ndërruar universitetin? Faleminderit!	07.11.2025	Përsëndetje, Ju duhet të dorëzoni pranë AKFAL vërtetimin për fillimin e studimeve në ciklin master. Faleminderit	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
44	03.11.2025	Pershendetje, Shume faleminderit per informacionin e dhene. Do doja te senjalizoja se aplikimet per kredi studentore jane mbyllur perpara dates se shenuar ne e-Albania. (bashkengjis foto dokumentuese) Kjo gie u ka hequr mundesine atyre studente qe kishin planifikuar te aplikonin ne vijim te dates 31, brenda dates 5 Nentor, qe te regjistrojne kerkesen e tyre. Mund te me thoni nese behet fjale per nje gabim te sistemit ose te shenimit te dates "5 Nentor" apo nese ka pasur rrethana te tjera qe kane cuar ne nje mbyllje paraprake? Nese parashikohet te hapen perseri, jane te njohura datat e ardhshme? Ju falenderoj dhe qendron ne pritje te përgjigjes suaj. Ju uroj nje jave te mbare.	03.11.2025	Përsëndetje , Afati për aplikimet vijon të jetë i hapur deri më datë 5 nëntor 2025. Ju lutemi të tentoni sërish pasi mund të ketë qenë një ngarkesë momentale apo gabim teknik në sistem. Faleminderit për mirëkuptimin!	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
45	06.11.2025	Pershendetje. Doja te aplikoja per kredi studentore por ka mbaruar afati. Nuk munda te aplikoj me heret pasi sot arrita te perfundoj dokumentat qe duhen per aplikim,dhe kur u ktheva ne shtepi te perfundoj aplikimin ishte mbyllur. Ju lutem me ndihmoni sepse nuk marr asnje ndihme pervec nje pensioni 4500 te reja ne muaj si jetime. Ju faleminderit.	06.11.2025	Përsëndetje, Kuptojmë situatën tuaj dhe ju falenderojmë që na kontaktuat. Në vijim të kërkesës suaj, ju informojmë se mund të paraqiteni pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) për të dorëzuar dokumentacionin përkatës, në mënyrë që të shqyrtojmë me kujdes mundësinë e trajtimit të rastit tuaj. Ju lutemi të sillni edhe vërtetimin që dëshmon statusin tuaj si jetime, së bashku me dokumentet e tjera të nevojshme për aplikimin. Faleminderit për mirëkuptimin!	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
46	10.11.2025	Përsëndetje, Jam student në vitin e parë të ciklit Master në Universitetin e Sporteve të Tiranës. Sipas thirrjes së institucionit tuaj (AKFAL) për kredi studentore, në datën 05.11.2024, në orën 16:12, ngarkova dokumente e kërkuara në portalin e-Albania. Megjithatë, sistemi nuk i pranoi, ndonëse afati për aplikim ishte deri më datë 05 nëntor 2024, ora 16:30. Duke marrë parasysh që sistemi është mbyllur përpara afatit të përcaktuar, ju lutem të merrni në shqyrtim kërkesën time. Bashkëngjitur po ju dërgoj dokumentet përkatëse dhe fotografinë e ekranit të aplikimit në e-Albania. Faleminderit për mirëkuptimin! Me shpresë për një zgjidhje pozitive,	10.11.2025	Përsëndetje , Faleminderit për kontaktimin tuaj. Në vijim të verifikimit, ju bëjmë me dije se afati për aplikimin në skemën e kreditimit studentor ka përfunduar më 05.11.2025, ora 16:30, ndërsa emaili juaj është dërguar më 06.11.2025, pra pas mbylljes së sistemit të aplikimeve në e-Albania. Edhe pse keni deklaruar se keni tentuar të ngarkoni dokumentet në orën 16:12 të datës 05.11.2024, aplikimi nuk është regjistruar me sukses në sistem brenda afatit zyrtar. Në mungesë të një defekti të përgjithshëm teknik të konstatuar zyrtarisht, ky rast nuk përbën shkak për mbivendosje afati dhe, për rrjedhojë, nuk mund të merret në shqyrtim në kuadër të kësaj thirrjeje. Ju sugjerojmë të ndiqni njoftimet në faqen zyrtare të AKFAL dhe në portalin e-Albania për hapjen e thirrjeve të ardhshme. Faleminderit për mirëkuptimin!	Përgjigjia jepet e plotë	Jo

47	11.11.2025	Përshendetje: Ctoj që ky email ju gjeje mirë. Jam studente e vitit I, dega: Arkitektura Peizazhi pranë Universitetit Buajësor të Tiranës. Kam përfunduar arsimin e mesëm të lartë me mesatare 10.0 përgjatë 3 viteve dhe mesatare VKM 9.99 (bashkë me Maturën Shtetërore). Kësaj, jam përfuturse e mbështetjes financiare për kategorinë "Studentët e shkëlqyer" (të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.0 dhe janë vlerësuar në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore me jo më pak se 9.5 (shkallëzuar)). Kur provova të bëj aplikimin në e-albania si është udhëzuar nga AKFAL, m'u shfaq ky mesazh: "Kujdes! Të dhenat tuaja mbi programin e studimit që ndiqni nuk janë përdatësim nga universiteti në SMIAL. Ju lutem drejtohani universitetit për përdatësimin e të dhenave në SMIAL per te vijuar më tej." U konsultova me zyrën e financës pranë fakultetit tim në UBT dhe më thanë që do të zgjidhet si problem teknik nga IT e universitetit dhe që duhet të pres rreth dy javë. Sot bëhen fiks 2 javë dhe u interesova sërish. Më thanë që të shfaqom fizikisht pranë zyrave të AKFAL, Tiranë si edhe u nënkuptua që të mos tentoj më me aplikimin në e-albania. A mund të ma konfirmoni ju më saktësisht? Si duhet të procedoj në vijimësi? Në pritje të përgjigjes tuaj,	11.11.2025	Përshëndetje, Në përgjigje të emailit tuaj , ju informojmë siç është publikuar dhe në faqen e webit akfal.gov.al; Se për studentët që hasin probleme gjatë aplikimit në platformën e-Albania, aplikimet mund të dorëzohen pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), në adresën: Rruga "Naim Frashëri", nr. 37, Tiranë, brenda periudhës 22 Tetor – 20 Dhjetor 2025. Lista e dokumenteve: Për studentët e shkëlqyer: 1. Formulari i Aplikimit; 2. Fotokopje Dokument Identifikimi; 3. Fotokopje të Diplomës dhe Certifikatës së Maturës Shtetërore. Për studentët finës të olimpiadave / në programe prioritare: 1. Formulari i Aplikimit; 2.Fotokopje Dokument Identifikimit Ditë të mburë,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
48	14.11.2025	Pershendetje, Ju lutem qe ky vjrtetim te jete i konfirmuar dhe i protokollluar nga universiteti, ne menyre qe te mund te merret ne konsiderate ne proceduren perkatese. Ju lutemi ta percillni dokumentin e protokollluar brenda ditës së nesërme, në mënyrë që të vijojmë me finalizimin e procesit lidhur me skemën e kreditimit studentor. Faleminderit për bashkëpunimin!	17.11.2025	Përshëndetje, Në vijim të emailit tuaj ju informoj se: Ju duhet të paraqiteni fizikisht pranë zyrave të AKFAL për të bërë aplikimin, pasi sistemi nuk është i aksesueshëm. Për çdo informacion ndiqni faqen tonë të web-it https://akfal.gov.al/sq/ Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
49	18.11.2025	Pershendetje! Jam e interesuar per mbeshtetjen financiare per studentet e shkëlqyer. Jam studente e vitit te pare ne FDUT, me mesatare gjimazi 10.00 , vkm 9.89 dhe provimet e matures mbi 9.5. U perpoqa te bej aplikimin ne e-albania dhe me del si ne foton e bashkangjitur. Me ndihmoni dot ju lutem pasi u perpoqa te marr informacion prane sekretarise se universitetit por me thane qe nuk ishin ne djeni. Faleminderit paraprakisht,	18.11.2025	Përshëndetje, Në vijim të emailit tuaj ju informoj se: Ju duhet të paraqiteni fizikisht pranë zyrave të AKFAL për të bërë aplikimin, pasi sistemi nuk është i aksesueshëm. Për çdo informacion ndiqni faqen tonë të web-it https://akfal.gov.al/sq/ Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
50	18.11.2025	Pershendetje - Sa mund te vonoj miratimi i kredise studentore ? Faleminderit !	18.11.2025	Përshëndetje, Sapo të miratohet lista përfundimtare e përfuturve të kredisë studentore, do të njoftoheni menjëherë me email. Faleminderit!	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
51	19.11.2025	Pershendetje, Shpresoj te jeni mire! Kam kryer një aplikim tek zyrat e akfal për mbështetje financiare pasi plotësoj kriteret e nxënësve ekselente. Nëse mundeni ju lutem më dërgoni dot numrin e aplikimit që të kem mundësi dhe ta gjurmtoj në portalin e-albania? Ju faleminderit,	19.11.2025	Përshëndetje, Ju keni aplikuar pranë AKFAL për përfitimin e mbështetjes financiare si studente e shkëlqyer me aplikimin nr. 206/29 prot., datë 31.10.2025. Afati i fundit i aplikimeve është 20.12.2025, më pas fillon faza e verifikimit sipas VKM nr.386/2022, i ndryshuar. Ju do të njoftoheni me email nëse plotësoni kriteret për përfitimin e mbështetjes financiare. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
52	19.11.2025	Doja te pesja se per cfar aplikimi behet fjal te lista e dokumenteve qe kerkohen per aplikimin e burses?	19.11.2025	Përshëndetje, Në lidhje me pyetjen tuaj, ju sqarojmë se formulari i aplikimit plotësohet fizikisht pranë zyrave të AKFAL. Ju lutemi të paraqiteni me dokumentacionin përkatës sipas listës së publikuar. Faleminderit dhe ditë të mburë!	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
53	21.11.2025	I/e nderuar, Në vijim të njoftimit të AKAFAL për mbështetje financiare për nxënës të ekselentë, ju drejtohem për të kërkuar informacion mbi kriteret, afatet dhe procedurat e aplikimit. Aktualisht jam student në Fakultetin e Mjekësisë, ndërsa gjatë arsimit të mesëm kam qenë nxënës ekselent me VKM 9.86 dhe jam vlerësuar me Medaljen e Artë. Për referencë, paraqes rezultatet e mia akademike: Mesatarja e tre viteve të gjimnazit: 10.0 Provimet e Maturës Shtetërore: Gjuhë shqipe dhe letërsi: 9.57 Matematikë: 9.5Gjuhë e huaj (Anglisht): 10.0 Lëndë me zgjedhje (Biologji): 9.79 Ju lutem të më informoni mbi: Kriteret e përfitimt të mbështetjes financiare për kategorinë e nxënësve ekselentë; Nëse procedura e përgjigjesjes realizohet sipas kuotave dhe nëse prioritet u jepet kandidatëve me mesatare më të lartë; Afatet e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për studentët aktualë; Detyrimet dhe përgjegjësitë që ka përfutresi i mbështetjes financiare; Çdo informacion tjetër që konsiderohet i rëndësishëm. Ju falënderoj për vëmendjen dhe mbetem në pritje të përgjigjes suaj. Me respekt,	21.11.2025	Përshëndetje, Në zbatim të VKM nr.386/2022, i ndryshuar pika 2.a "Mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit ose të ardhura të tjera të ligjshme, që studentëve shtetas shqiptarë, të punuar në institucionet publike të arsimit të lartë, që nuk janë njëkohësisht përfutres të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar dhe që plotësojnë kriteret e mëposhtme: a) Studenti me notë mesatare në pranim, që: i. ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00; ii. në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00. " Afati i aplikimeve është deri në 20 dhjetor. Dokumentacioni që studentët duhet të dorëzojnë në AKFAL janë: - 1. fotokopje e Diplomës së shkollës së mesme - 2. fotokopjen e Certifikatës së Maturës Shtetërore, - 3. fotokopje të kartës së identitetit, - 4. formularin e aplikimit që e plotëson fizikisht në AKFAL. Për studentët e shkëlqyer nuk ka kuota, pra përfitojnë mbështetje financiare të gjithë studentët që plotësojnë kriterin e mësipërm. Sipas pikës 3 të VKM nr.386/2022, i ndryshuar " Mbështetjen financiare, e përfiton studentin për program të parë studimi dhe që përmant: a) të nënshkruajë marrëveshje, b) të punojë në profesionin për studimet e të cilët përfiton financim nga momenti që i lind e drejta për të punuar, bazuar në legjisllacionin në fuqi, në sektorin shtetëror, për jo më pak se 3 (tre) vjet, përshirë edhe rastin kur i ndërpretet financimi, për shkak të mos përmbushjes së kriterit të notës mesatare gjatë studimeve; c) të kalojë zyrarisht diplomën e origjinale përkatëse të arsimit të lartë, për të cilin përfiton financim, nga institucioni publik i arsimit të lartë ku ka përfunduar studimet të institucioni apo subjekti juridik ku punësohet, deri në shlyerjen e detyrimeve, sipas marrëveshjes së parashikuar në këtë vendim." Studenti përfutres me qëllim vijimin e financimit, duhet të ruajë notën mesatare, jo më pak se 9.5 gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të ciklit të parë dhe të dytë ose gjatë ndjekjes së studimeve të integruara të ciklit të dytë në institucionin publik të arsimit të lartë. Ato përjashtohen nga pagues e kartës vjetore të shkollimit dhe financohen në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi. Përfutresi, pas nënshkrimit dhe fillimit të pasqave juridike që rrjedhin nga marrëveshja, ka të drejtë të paraqesë kërkesat me shkrim, drejtuar dy palëve të tjera të marrëveshjes, për zgjidhjen e saj, duke qenë i detyruar të kthejë 100% të përfitimt financiar të marrë deri në momentin e prishjes së marrëveshjes. Në rast se zgjidhja e marrëveshjes bëhet nga përfutresi pas diplomimit, përfutresi, pasi të ketë kthyer të gjithë përfitimmin financiar, ka të drejtë të pajset me diplomën origjinale nga IAL-ja. Për çdo pyetje që mund të keni mund të na kontaktoni sërish. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo

54	21.11.2025	Iu përshëndes, nuk iu shkruaj për të marrë vedhë për zhvillimet për rifinancimin sepse kam marrë përgjigjen që po shqyrtohen dokumentacionet por kam nevojë diçka nga ju gjithmonë nëse e keni të mundur dhe nëse lejohet. Po kërkoja kontratën 3 palëshe që kemi firmosur por nuk po e gjej dhe kam frikë mos e kam humbur. Iu lutem a e keni të mundur të më nisini një kopje të saj në mënyrë elektronike (e skanuar mund të jetë një mënyrë apo si ta keni ju më të thjeshtë). E kam firmosur me datën 8 shkurt 2023 nëse nuk gaboj, ose 8 ose 9 kjo është e sigurt. Do iu isha shumë falenderues nëse do mund të ma dërgoni sepse gjithmonë përpiqem të jem korrekt për sa i përket dokumentave dhe ngaqë nuk po e gjej realisht po shqetësohem sepse dokumenti duhet në çdo kohë. Iu shkruajta ju sepse merrni specifikisht me këtë pjesë sepse nëse paraqitem në universitet do vonohet shumë sepse ka pasur administratë tjetër në vitin 2023 dhe kanë edhe shumë dokumenta të llojeve tjera nëpër duar dhe kjo është logjike. Në pritje të kësaj kërkesë, për të cilën përsëris, vetëm nëse e keni të mundur nga kana rregullative sepse nuk dua të abuzoj sepse gjithmonë duhet të jemi në rregull me ligjin, do iu isha mirnjohës nëse mund të dërgoni një kopje të asaj kontrate të firmosur në shkurt të vitit 2023.	25.11.2025	Përsëndetje, Në vijim të emailit tuaj ju informoj se: Ju duhet të përgatitni një kërkesë me shkrim ku kërkonti një fotokopje të marrëveshjes së nënshkruar, si dhe një fotokopje të kartës së identitetit. Këto dy dokumente duhet ose t'i përcillni fizikisht pranë AKFAL ose mund t'i dërgoni me postë në adresën : "Rruga" Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë Iu lutem, nëse i dërgoni me postë shkruani dhe adresën tuaj. Faleminderit	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
55	27.11.2025	pershendetje jam studente nga Shqipria me studime ne Kosove kam mesatare prej 9.5 dhe jam e interesuar per ket mbeshtetje por nuk me funksionon per aplikim si mundem me apliku	03.12.2025	Përsëndetje, Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë se, sipas VKM nr. 386/2022, i ndryshuar, mbështetja financiare përfitohet vetëm nga studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Pasi ju nuk ndiqni studimet në një IAL publike në Shqipëri, nuk përfitoni mbështetje financiare. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo